



KOMUNIKATË 22.01.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e mbajtur sot, në fillim të shqyrtimit të rendit të ditës, ka miratuar me pakë vërejtje raportet nga mbledhjet e kaluar. Janë miratuar raportete nr. 62/09, 63/09, 83/0986/09 dhe 87/09. Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, e ka informuar KQZ-në për aktivitetet dhe përgatitjet që lidhen me rivotimin për Kryetar të Komunave në Prizren dhe Lipjan. Z. Peqani, ka thënë se janë përfunduar trajnimet një ditore të KVV-ve për komunën e Lipjanit dhe Prizrenit. Trajnime do të mbahen edhe për ditën e dytë, të shtunën më 23.01.2009. Fletëvotimet janë prodhuar dhe, do sillen në Kosovë me përcjellje të policisë speciale me 25.01.2010. Kryeshefi Peqani, e ka informuar KQZ-në edhe lidhur me fillimin e përgatitjes së pasqyrës financiare për vitin 2009, e cila duhet t'i dorëzohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave deri më 31.01.2010. Janë duke u bere pagesat e mbetura për disa anëtarë të KKZ-ve, Qendrave alternative dhe stafit të QNR-se. Janë proceduar për refundim depozitat certifikuese të atyre subjekteve politike të cilat kanë fituar së paku një ulëse në kuvendet komunale. Refundimi është bërë në xhirollogarinë bankare të deklaruar nga subjekti politik në kërkesën e tij për certifikim.

Në vazhdim, z. Peqani, e ka informuar KQZ-në se është kryer punimi i vulave të reja për vulosjen e fletëvotimeve dhe është vazhduar kontrata me operatorët ekonomik për transportin e materialit sensitiv dhe jo sensitiv. Janë duke u bërë përgatitjet së bashku me IFES-in për selektimin e stafit të QNR-se. Ka filluar klasifikimi dhe evidentimi i materialit zgjedhor sensitiv dhe josensitiv. Kanë filluar përgatitjet për evidentimin e materialit për shkatërrim materialin, i cili do të shkatërrohet brenda 60 ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga KZAP-i (Ligji Nr. 03/073, neni 103.4). Gjithashtu, ka informuar z. Peqani, kanë filluar përgatitjet për hartimin e Raportit Vjetor për Kuvendin e Kosovës.

Në vazhdim të mbledhjes, znj. Miradie Mavriqi, drejtoreshë e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, i ka paraqitur KQZ-së rekomandimet për akreditim të vëzhguesëve për rivotim në komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit. Në bazë të Vendimit të datës 12.01.2010 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ripërtrirjen e distinktivëve për vëzhguesit e akredituar më parë për vëzhgim të procesit zgjedhor, si dhe akreditimin e vëzhguesve shtesë, dhe në bazë të rregullës Zgjedhore nr 10/2009 Raundi i dytë i zgjedhjeve për Kryetarë të Komunave.

Znj. Miradie Mavriqi, e ka informuar KQZ-në se deri më 19 janar, ZRPP ka proceduar aplikacionet e vëzhguesve të një (1) partie politike, një (1) organizate ndërkombëtare dhe një (1) ambasade. Raporti përmban rekomandimin për akreditim të gjithsej 915 vëzhguesve si dhe për ripërtrirjen e distinktivëve të gjithsej 26 vëzhguesve. KQZ ka miratuar aplikimet për këta vëzhgues.

Në vazhdim të mbledhjes, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shqyrtuar edhe kërkesat e Partisë Lidhja Demokratike e Kosovës drejtuar KQZ-së për shtimin numrit të vëzhguesëve në vendvotime të caktuara në procesin e rivotimit në Prizren dhe Lipjan. Pas shqyrtimit të këtyre kërkesave, KQZ-së nuk i ka miratuar ato për faktin se nuk mund të bëhen seleksionime në këtë drejtim për VV të caktuara. KQZ është e mendimit që masat e sigurisë të jenë të shtuara dhe rivotimi të realizohet sipas planit dhe në mënyrë sa më profesionale.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjithashtu ka shqyrtuar dhe ka miratuar kërkesën e Presidencës së Republikës së Kosovës për konfirmimin e kandidatëve të subjekteve përkatëse që janë në listë nga zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Kosovës për t'i zëvendësuar deputetët të cilët janë zgjedhë kryetar të Komunave në Zgjedhjet Lokale 2009: Rasim Selmanaj (AAK), Agim Veliu (LDK) dhe Bojan Stojanović (SLS). Sipas kësaj kërkesë, KQZ i ka konfirmuar Presidencës se sipas radhës, në listë të deputetëve pasojnë: Bujar Dugolli (AAK), Lutfi Zharku (LDK) dhe Petar Miletiq (SLS).